



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Kosova
Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Prizren, 01.04.2026

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në bazë të Rregullores MF –Nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik për OJQ-të dhe Rregullores Komunale nr. 001/011-201 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Transfereve dhe Granteve hapë:

THIRRJE PUBLIKE

1. Për të gjitha Organizatat Jo-Qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës dhe Individ që veprojnë në Komunën e Prizrenit, programi i punës i cili është i fokusuar në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe që përfshijnë aktivitete të realizuara në Komunën e Prizrenit, të aplikojnë për mbështetje financiare:

Në fushën e Kulturës:

Lot 1

U dedikohet organizatave kulturore që veprojnë në Komunën e Prizrenit dhe që operojnë gjatë tërë vitit dhe kanë aktivitete kulturore të nivelit kombëtar dhe mbarëkombëtar, të cilat kontribuojnë në mënyrë të dëshmuar në zhvillimin kulturor, ekonomik dhe shoqëror, të Komunës së Prizrenit. Organizatat kulturore që posedojnë struktura të qarta qeverisëse, si dhe strategji afatshkurtëra dhe afatmesme organizative dhe programore.

- a) Përkrahja e programit vjetor të organizatave;
- b) Promovimi kulturor të Komunës së Prizrenit;
- c) Krijimi i produkteve të reja kulturore;
- d) Ofrimi i programeve edukative për publikun e Komunës së Prizrenit;
- e) Organizimi i festivaleve, shfaqjeve teatrale, film, film dokumentar, koncerteve, ekspozita, ngjarjeve historike e të tjera brenda territorit të Komunës së Prizrenit.

Kjo kategori e organizatave, përveç dokumenteve bazike të kërkuara duhet të na ofrojë edhe:

- Strategjinë e Organizatës për periudhën 2026-2028;
- Ndikimi ekonomik për Komunën e Prizrenit (dëshmi nga viti 2025)
- Burimet njerëzore të OJQ-së (dëshmi nga TRUSTI);
- Audienca e performancës (dëshmi foto nga viti 2025)

Lot II

a) Të gjitha OJQ-të dhe Individëve të interesuar;

b) Të aplikojnë me një projekt në njërin prej fushave të poshtëshënuara;

- *Manifestime*: Shënimi i datave historike, shënimi i festave kombëtare dhe ndërkombëtare dhe shënimi i datave të tjera me rëndësi në Komunën e Prizrenit;
- Mbështetja e aktiviteteve vjetore të organizatave dhe operatorëve kulturor;
- *Muzikë*: Kompozimi i veprës së re, audio incizim, koncert, fuqizimi i muzikantëve të rinj;
- *Shoqëritë Kulturore - Artistike*: Mbështetje e aktiviteteve në promovimin e krijimtarisë lokale artistike, shënimi i datave historike kombëtare dhe ndërkombëtare dhe datave tjera me rëndësi për Komunën e Prizrenit;
- *Teatër*: Prodhimi i shfaqjes, promovimi dhe pjesëmarrje e shfaqjes në festivale kombëtare dhe ndërkombëtare;
- *Kinematografi*: Film dokumentar, film i shkurtër, fuqizim i kinematografëve të rinj në ruajtjen e traditave lokale dhe trashëgimisë kulturore të Komunës së Prizrenit;
- *Art Vizual - Figurativ*: Krijimi i veprës së re, fuqizimi i artistëve të rinj, ekspozita të organizuara në hapësira publike;
- Mbështetja e aktiviteteve edukativo-kulturore për vetëdijesimin e ekstremizimit;
- Botimi dhe promovimi i librave;
- Blerja e veprave artistike.

Në fushën e Rinisë:

Synimet specifike:

- Mbështetja e aktiviteteve rinore, promovimi i vullnetarizmit, integrimi i grupeve rinore dhe atyre të marginalizuara, mbështetja e ideve-projekteve si dhe promovimi i talentëve të rinjë;
- Organizime për shënimin e datave kombëtare dhe ndërkombëtare me karakter rinor;
- Edukimi jo formal: Trajnime, Punëtori, Debate, Hulumtime, për të rinjtë që ndikojnë drejtpërsëdrejti në nxitjen e aktiviteteve rinore dhe luftimin e dukurive negative tek të rinjtë;
- Mbështetja për përfshirjen sociale dhe organizimi i ngjarjeve promovuese dhe rekreative.
- Mbështetje të personave me projekte inovative;
- Mbështetje të personave me nevoja të veçanta.

Në fushën e Sportit:

Lot I

U dedikohet subjekteve apo klubeve të Komunës së Prizrenit, që operojnë gjatë tërë vitit dhe që posedojnë struktura të qarta udhëheqëse dhe strategji organizative dhe programore.

- a) Të kenë në gjirin e tyre disa prej këtyre ekipeve; seniorëve, të femrave, juniorëve, kadetëve dhe pionierëve (të ofrohen dëshmi për këto kategori);
- b) Të kenë në gjirin e tyre 200 sportistë aktiv të regjistruar në klub (vërtetim na Federata përkatëse apo Lidhja Rajonale e Futbollit – i vulosur);
- c) Të kenë në gjirin e tyre së paku 4 trajner të licencuar nga Federata gjegjëse (e dëshmuar me vulë të fedratës përkatëse dhe kontratat aktive me klubin përkatës);
- d) Vërtetim i licencimit të klubit (nga Federata përkatëse ose Lidhja Rajonale e Futbollit);
- e) Vërtetim që merrë pjesë në gara republikane ose regjionale (nga Federata përkatëse ose Lidhja Rajonale e Futbollit – i vulosur)
- f) Vërtetim nga Federata ose Lidhja Rajonale e Futbollit që asnjë zyrtar i klubit ose lojtarët nuk janë të dënuar për dhune fizike në ndeshjet zyrtare – i vulosur);
- g) Të kenë çmime të fituara kombëtare dhe ndërkombëtare.
- h) Të sjellin dëshmi për rezultatet e tyre në 3 vitet e fundit;
- i) Të kenë traditë të gjatë të veprimtarisë;

Lot II

- Të gjitha OJQ-të dhe Individëve të interesuar në fushën e sportit;
- Të aplikojnë me një projekt në njërin prej fushave të poshtëshënuara;

Projektet të cilat mbështeten në fushën e sportit:

- Zhvillimi i sportit në Komunën e Prizrenit;
- Masivizimi i sportit (masivizimi i sportit për të rinj, avancimi i aktiviteteve në klubet sportive të femrave, integrimi i personave me aftësi të kufizuar në aktivitete dhe gara sportive);
- Organizimi i aktiviteteve sportive;
- Promovimi i talentëve të rinjë;
- Gazetarët sportiv;
- Botimi dhe promovimi i librave dhe revistës vjetore sportive;
- Pjesëmarrje gara aktivitete tjera kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Manifestime: shënimi i datave historike, shënimi i festave kombëtare dhe ndërkombëtare, shënimi i datave tjera me rëndësi për Komunën e Prizrenit;

2. Vlerësimi i projekteve do të bëhet nga një komision 5 anëtarësh, të cilët do t'i vlerësojnë projektet në bazë të kriterëve për vlerësim, sipas rregullores MF-NR 04/2017 mbi kriteret dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve he Rregullores Komunale nr. 001/011-201 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Transfereve dhe Granteve.
3. Aplikimi i OJQ-ve do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

Formulari i Aplikacionit (Formulari 9) për projekt/programin (e shtypur);

Formulari i Buxhetit (Formulari 10) për projekt/programin (e shtypur);

Formulari i 11 i deklaratës për mungesë të financimit të dyfishtë (e shtypur);

Formulari i 12 Deklarata e Partneritetit (vlen për OJQ-të që kanë partner në projekt);

Formulari i 13 Deklaratë mbi projektet e financuara nga burimet publike të financimit në vitin 2024 dhe 2025 (vlen vetëm për OJQ-të që kanë përfituar fonde);

Dokumenti identifikues (i personit të autorizuar të OJQ-së);

Çertifikata e regjistrimit OJQ;

Çertifikata e numrit fiskal të OJQ-së;

Letërkonfirmimi i personit të autorizuar të OJQ-së (jo më i vjetër se 3 muaj)

Dëshmi që nuk ka obligime ndaj ATK-së (jo më të vjetër se 1 muaj);

Dëshmi që ka dorëzuar raportet financiare dhe narrative nga vitet paraprake 2024 dhe 2025 (vërtetime që janë lëshuar DKRS);

Konfirmim nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit (e shtypur);

Çertifikatën që nuk jeni nën hetime (Për personin e autorizuar i OJQ-së);

Deklaratën nën betim

1. Aplikimi i Individëve do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

- Formulari i Aplikacionit për projektin;
- Formulari i deklaratës për mungesë të financimit të dyfishtë;
- Dokumenti identifikues;
- CV;
- Diplomë, licencë apo dëshmi relevante;
- Konfirmim bankar personal;
- Çertifikatën që nuk jeni nën hetime.
- Dëshmi që ka dorëzuar raportin financiar dhe narrativ nga viti paraprak 2025 (vërtetim i lëshuar DKRS);
- Për pjesëmarrje gara aktivitete tjera kombëtare dhe ndërkombëtare të dorëzohen këto dëshmi: ftesa ose kalendari i garave në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar);

2. Formulari për aplikim mund të merret në web-faqe të Komunës dhe mund të dorëzohen duke filluar nga data **02.04.2026 – 27.04.2026 .**

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

Vlera e planifikuar e mbështetjes financiare për OJQ-të nga lëmia e Kulturës :

LOTO 1

- a. Shuma e mbështetjes financiare, që mund të alokohet nga fusha e kulturës për projektet që kanë përmbajtje serioze është **nga 5,000 € deri në 130,000 €;**

LOTO 2

- b. Shuma e mbështetjes financiare, që mund të alokohet nga fusha e kulturës për projektet që kanë përmbajtje serioze është **nga 2,000 € deri në 50,000 €;**

Vlera e planifikuar e mbështetjes financiare për OJQ-të nga lëmia e Sportit :

LOTO 1

- a. Shuma e mbështetjes financiare, që mund të alokohet nga fusha e sportit për projektet që kanë përmbajtje serioze është **nga 5,000 € deri në 130,000 €;**

LOTO 2

- b. Shuma e mbështetjes financiare, që mund të alokohet nga fusha e sportit për projektet që kanë përmbajtje serioze është **nga 2,000 € deri në 50,000 €;**

Vlera e planifikuar e mbështetjes financiare për OJQ-të nga lëmia e Rinisë :

- a) Shuma e mbështetjes financiare, që mund të alokohet nga fusha e rinisë për projektet që kanë përmbajtje serioze është **nga 2,000 € deri në 10,000 €;**

Vlera e planifikuar e mbështetjes financiare për Individ:

LOTO 2

- Shuma e mbështetjes financiare, që mund të alokohet nga fusha e kulturës për projektet që kanë përmbajtje serioze është **nga 1,000 € deri në 5,000 €;**

Vlera e planifikuar e mbështetjes financiare për OJQ-të nga lëmia e Sportit :

LOTO 2

- Shuma e mbështetjes financiare, që mund të alokohet nga fusha e sportit për projektet individuale është **nga 1,000 € deri në 5,000 €;**

Vlera e planifikuar e mbështetjes financiare për Individ nga lëmia e Rinisë :

- b) Shuma e mbështetjes financiare, që mund të alokohet nga fusha e rinisë për projektet që kanë përmbajtje serioze është **nga 1,000 € deri në 5,000 €;**

Kushtet e pergjithëshme për aplikim:

1. Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të, që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave Jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës.
2. Aplikuesit duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në njërën nga fushat e aplikimit.
3. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Komunës së Prizrenit - Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.
3. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare të Komunës së Prizrenit.
4. Nuk do të mbështeten OJQ-të të cilat nuk kanë fushveprimtari kulturore, rinore dhe sportive.
5. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht, në adresën e mëposhtme:
-
Komuna e Prizrenit,
Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
Sporteli nr.1-2-3-4 në ndërtesën e Komunës,
20000 Prizren.
6. Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i komenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara.
9. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Kushtet e veçanta të thirrjes:

- OJQ-të të cilat vendosen në listën përfundimtare të përfituesve për vitin 2026 e të cilat ishin përfituese të vitit 2025 (të cilat mjetet i kanë pranuar me vonesë), kontratat do t'i nënshkruajnë pasi që OJQ-të të sjellin raportin financiar dhe narrativ të vitit 2025 në harmoni me F10 e dorëzuar në aplikimin e tyre;
- OJQ-të sportive të cilat parashohin aktivitete shtesë në kuadër të "Prizreni Qytet Evropian i Sportit" do të kenë përparësi;

Vërejtje:

Komuna e Prizrenit - Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport këtë vit do të përkrah ato projekte që janë serioze dhe që kanë programet në interes të promovimit të kulturës, sportit dhe rinisë për qytetin dhe qytetarët e Komunës së Prizrenit.

Projektet të cilat nuk i kanë të bashkangjitura dokumentet sipas kërkesës nuk do të merren parasysh nga Komisioni për shqyrtimin e kërkesave.

Shpenzimet e papranueshme përfshijnë: bonuset apo shpërblimet, inventari, qiraja për zyre, komunalit (rrymë, ujë) si dhe nuk përkrahen projektet e OJQ-ve që mund të kenë ndikim politik, religjioz etj.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport nuk është e detyruar të ndajë të gjithë buxhetin e paraqitur të planifikuar në projekt - aplikacion.

Buxheti do të ndahet për projektet kualitative të vlerësuara nga komisioni.

Me respekt,

Drejtoreshë e DKRS-së
Ajlin Shishko Hajdari

